

NË VEND TË PARATHËNIES

Diell i freskët i ndritshëm; ajër i kthjellët i kulluar si ujë; dëshirë për ta ngrirë momentin pezull, në emër të përjetimit. Kështu nisi për mua dita e 11 shtatorit 2001, në orën 8:30 të mëngjesit, tek hiqja këmbët zvarrë ende i përgjumur, për të mbuluar distancën e shkurtër midis pallatit tim dhe hyrjes së stacionit të metrosë në rrugën 205 të Bronx-it. Pasi hyra e zura vendin tim të preferuar në vagon, bëra çka kisha bërë rregullisht çdo ditë, qëkur isha përfshirë në rutinën e mëngjesit: mbështeta kokën në qelq të dritares dhe dremita. Linjës D i duhen rreth 40 minuta për të arritur në Times Square, ku edhe punoja atë periudhë; dhe 40 minuta janë kohë e mjaftueshme për të rikuperuar sado pak gjumë nga nata gjithnjë e pamjaftueshme. Gjithsesi, atë ditë m'u bë sikur treni u vonua pak diku nën Central Park; dhe lajmërimet e mbytura për vonesat ma trazuan pak gjumin, përndryshe aq të mirëpritur.

Më në fund, rreth orës 9:30, dola prej nëntoke në stacionin e Avenusë së 6-të, mu në zemër të Manhattan-it – i njëjti ajër i freskët i ndritshëm dhe diell i kthjellët i kulluar si ujë. Me bisht të syrit, dallova më pak trafik se zakonisht; meqë në atë orë Avenuja e 6-të zakonisht gëlon nga taksitë dhe furgonat që furnizojnë dyqanet dhe restorantet e shumta. Më tërhoqi vëmendjen edhe një makinë e çuditshme, me një formë të gabuar, të keqe; diçka si një mizë krahshkukur, ose tjetër kandërr agresive, që më kaloi përmbri me alarm të pazakonshëm. Kapërceva Broadway-n dhe Avenunë e 7-të, dhe mbërrita në zyrë, ende më shumë i fjetur sesa i zgjuar. Mu në hyrje të katit, ulur në tryezën çuditërisht të zbrazët të recepsionit, më doli përpara pastruesi Braulio, portorikan veteran, i cili me spanjishten e vet të shpejtë filloi të më kumtonte diçka urgjente për një avion të rrëzuar; jo, të përplasur; por edhe që lidhej njëfarësoj me “kullat binjake”. Ndërkohë m'u dëgjua një gërvimë radioje, nga njëra prej zyrave. Shkova atje, për

t'i gjetur praktikisht të gjithë kolegët të mbledhur rreth radios, mbi një rënë prej skrivanive. Ishte një radio që e përdornin zakonisht për të matur mërzinë e ditës në zyrë, e që nuk e kisha dëgjuar kurrë të fliste ose të luante muzikë; më shumë orendi sesa mjet komunikimi; objekt i pluhurosur e i vjetruar, model tashmë i hequr nga tregu, markë e falimentuar prej vitesh.

Dy avionë pasagjerësh qenkëshin përplasur me rrokaqiejt e World Trade Center; askush nuk dinte pse dhe si. Pak pasi kisha hyrë unë në zyrë, lajmëruan se po shembej përdhe kulla jugore (2WTC, pikërisht në 9:59 AM). Po shembej përdhe kulla jugore? Mendja kërkonte kohë për ta përpunuar një informacion të tillë. Ndërkohë, kullat binjake më faniteshin obsesivisht siç i kisha parë për herë të fundit, nga poshtë, me qafën të përthyer deri në dhimbje. Me disa kolegë vendosëm të dilnim për një kafe, ose edhe për t'u orientuar pak më mirë, përballë këtij rimodelimi të vrazhdë të realitetit. Te një vetrinë banke në Avenunë e Shtatë, pamë pamjet televizive të pabesueshme të rrëzimit të kullës; ndërkohë që një zezak i veshur spic, i përfshirë njëkohësisht nga paniku dhe ngazëllimi maniakal, lajmëronte kalimtarët se ishte goditur edhe "Kremlini". Pak më vonë, kur ishte shembur tashmë edhe kulla veriore (1WTC, në 10:28 AM), u kuturisa deri në Avenunë e Gjashtë, për të parë sesi vija e drejtë e rrugës mbyllej brutalisht, kilometra më poshtë në horizont, nga një mur i hirtë tymi.

Ende nuk arrija t'i pranoja vetes se katastrofa e atij mëngjesi dhe qyteti që më rrethonte i përkisnin të njëjtit univers (çka e kam të vështirë ta pranoj edhe sot e kësaj dite, gjashtë vjet më pas). Por nuk m'u desh shumë të vija re se qielli mbi New York ishte zbrazur prej avionëve; pamje ndoshta edhe më e ankthshme sesa vetë shtëllungat kërcënuese në jug të Manhattan-it. Nga ajo ditë mbaj mend edhe kur u ngjita në tarracë të pallatit tim, në mbrëmje, për të kundruar puaplën

kobzezë të tymit, ende llamburitëse nga drita e perëndimit, që e kish ndarë tashmë qiellin përgjysmë. Natyrisht, nuk e mendoja dot, në atë moment, se jeta ime, ashtu si jeta e miliona banorëve të tjerë të metropolit, kishte ndryshuar tashmë në trajta nga më të dhimbshmet. Më pas do të thuhej se 11 shtatori ia hoqi krejt Amerikës virgjërinë, ose ndjenjën foshnjore të paprekshmërisë; duke ia shtuar një përmasë të pamirëpritur të frikës, më pas të rrëgjuar në paranojë; ose të indinjatës, më pas të rrëgjuar në vendosmëri për shpagim. Për mua, ndërkohë, sulmi ndaj World Trade Center ishte edhe shpërftyrim djallëzor i dy simboleve të historisë së dashurisë midis qytetërimit perëndimor dhe lartësisë: rrokaqiejt dhe avionët. Manhattan-in asgjë nuk e ka përfaqësuar më mirë, në imagjinatën kolektive, sesa e ashtuquajtura *skyline*, vijë a kontur i profilit të pyllit të ndërtesave shumëkatëshe, me qiellin në sfond; sikurse rrallëherë i qëllon banorit të këtushëm të ngrejë kokën, pa e parë të paktën një avion që vërtitet në qiell.

Me Kullat Binjake më lidhnin edhe disa kujtime të rastit: kërkesa për punë që i pata dërguar dikur një kompanie që i kishte zyrat aty; kafeja e mirë espresso që të bënin në *Coffee Station*, një prej bareve në qendrën tregtare të nëndheshme; flamurët shumëngjyrësh të vendeve anëtare të WTO, që ia zbukuronin *foyer*-in e që gjithnjë do ta mahnitnin time bijë, ende të mitur. Kur më patën çuar atje për herë të parë, pak pasi isha mbartur në New York, gjëja e parë që mendova sapo u përballa me vertikaltetin e pabesueshëm, ishte se kullat duhej të ishin bosh nga brenda; meqë asgjë njerëzore e mirëfilltë nuk mund t'ua toleronte vëllimin dhe lartësinë; prandaj do t'i pranoja më lehtë si monumente, ose obeliskë të Rendit të Ri Botëror amerikan të viteve 1990, sesa si vende ku njerëzit mund të punonin, të bënin telefonata, të pinin kafe dhe verë, të hanin pizza, të fotografonin njëri-tjetrin dhe të harronin, sado përkohësisht, se po banonin një përmasë përndryshe tabu.

Çuditërisht, vetëm kur ato ndërtesa u shembën duke marrë me vete më se 2700 viktimat, arrita ta pranoj përfundimisht se rrokaqiejt e WTC ishin ndërtesa reale; njëlloj si edhe pallati ku banoja, ose godina tjetër ku e kisha zyrën. Më vonë do të mësoja edhe se, nga 2700 të vrarët, të paktën 200 ishin hedhur drejt vdekjes prej zgavrave të dritareve në lartësi marramendëse, për t'u shpëtuar flakëve.

Kundërmimi i tmerrshëm i mishit dhe i kockave të shkrumbuara do të përhapej dalëngadalë në krejt Manhattan-in, së bashku me pluhurin nga ndërtesat e shkatërruara dhe blozën prej zjarrit infernal. Pas asaj dite, New York-u ndoshta do ta merrte veten, për t'u kthyer në shprehitë dhe automatizmat e detyrueshme prej metropoli botëror; por gëzimin e jetës qytetare nuk do ta rikuperonte dot më.

Terrorizmi do të bëhej, ndërkohë, element përcaktues i politikës amerikane, brenda dhe jashtë Amerikës. Historia e këtyre gjashtë viteve – histori e shkruar me dhunë, bomba, vdekje, vuajtje, kërcënime – shpërtheu e tëra prej atij mëngjesi fatal të 11 shtatorit 2001: të freskët, të ndritshëm, të kthjellët e të kulluar, si për të na kujtuar çfarë nuk do të mund të përjetonim dot më.

Kjo përmbledhje esesh, skicash dhe artikujsh s'është veçse një përpjekje imja për të kuptuar, ose përshkruar, neurozën post-traumatike të Amerikës, e ndoshta të krejt Perëndimit, pas tronditjes kapitale të asaj dite. Sulmet terroriste ndaj World Trade Center dhe Pentagonit, të përcjella e të amplifikuara me miliona herë nga televizioni, u shndërruan sakaq në një narrativë themeluese për shekullin XXI e në mit të origjinës për një botë të re e të ashpër, që ndoshta askush nuk e ka mirëpritur. Administrata e presidentit George Bush – që i kish fituar zgjedhjet e vitit 2000 në një klimë krejt tjetër e në vazhden e indinjatës amerikane për

aventurat seksuale të presidentit të mëparshëm Bill Clinton – u kap krejt e papërgatitur ndaj këtij zhvillimi; mbarë Amerika u kap e papërgatitur. Pati një të krisur në krejt rendin e sendeve.

Shumë amerikanë sot, madje edhe vetë Presidenti Bush, e kanë kuptuar se reagimi amerikan ndaj atentateve të 11 shtatorit ishte, në thelb, pjesë e planit madhor të autorëve të atyre atentateve. Edhe pse kultura zyrtare politike në Washington vijon t'i shpjegojë sulmet e atëhershme me arsyen retorike se "ata i urrejnë liritë tona", e vërteta është se qytetari amerikan, në këto gjashtë vite të fundit, ka ardhur duke i humbur një pjesë të të drejtave dhe lirive qytetare që përndryshe i njihen me kushtetutë. Ndërsa ushtria amerikane u dërgua përtej detit për ta çliruar Irakun nga diktatura e Saddam Hussein-it e për t'i dhuruar popullit të atjeshëm demokracinë, vetë vendimi i administratës Bush për ta konsideruar si "luftë" përgjigjen e vet anti-terror krijoi probleme të mëdha me kushtetutshmërinë, raportet e pushteteve dhe marrëdhëniet midis të drejtave të individit dhe arsyes shtetërore, ose famëkeqes *raison d'état*. Për pasojë, Amerika pas 11 shtatorit nuk është më parajsja e diellzuar e viteve klintoniane, me më shumë premtime se banorë. Sado paradoksale t'i tingëllojë kjo sot publikut shqiptar, Amerika vuan.

Një pjesë e madhe e materialeve të këtij vëllimi kanë dalë në rubrikën "Kushëriri nga Amerika", të gazetës "Bota Shqiptare", e cila botohet në Romë. Një pjesë tjetër, më e vogël, janë botuar në gazeta të tjera, si "Shekulli" e "Java". Shpresoj që, megjithëse shpesh u referohen ngjarjeve tashmë të shkuara, të mos e kenë humbur aktualitetin për lexuesin shqiptar.

New York, 7 shtator 2007